



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.11.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Diskutimi i projektrezolutës "Për ndërhyrjet e huaja në proceset elektorale dhe dezinformimin në proceset demokratike kombëtare"

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Ditmir Bushati, Eglantina Gjermeni, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Andrea Marto, Adnor Shameti, Ervin Bushati, Rudina Hajdari, Elona Hoxha, Evis Kushi, Ediola Braha, Zef Shtjefni, Ligoraq Karamelo, Vasil Sterjovski.

Mungojnë:

Fatmir Velaj, Halit Valteri, Vasilika Hysi

Të ftuar:

Taulant Balla, Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Politikës së Jashtme.

Përveç miratimit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar, në rend të ditës kemi diskutimin e projektrezolutës "Për ndërhyrjet e huaja në proceset elektorale dhe dezinformimin në proceset demokratike kombëtare".

Jemi komision për dhënie mendimi.

Relator është deputeti Bushati.

Të ftuar kemi kolegun Balla, kryetar i Grupit Parlamentar të PS-së.

Mirë se vjen, kolegu Balla, në këtë komision!

Përpara se të fillojmë me diskutimin e projektrezolutës, më lejoni t'i uroj mirëseardhjen deputetit Shtjefni.

Mirë se vjen, zoti Shtjefni, në komision! Ju uroj suksese dhe punë të mbarë!

Urdhëroni, zoti Balla!

Taulant Balla – Faleminderit, e nderuar kryetare!

Të nderuar anëtarë të KPJ-së të Kuvendit të Shqipërisë,

Jam këtu sot për të prezantuar argumentet dhe arsyet që qëndrojnë në bazë të kësaj projektrezolute. Siç e kemi shprehur qartë edhe në relacionin që e shoqëron projektrezolutën, shkas për propozimin dhe marrjen e iniciativës së depozitimit të këtij drafti për shqyrtim nga Kuvendi i Shqipërisë është rezoluta e Parlamentit Europian e votuar rishtas me 10 tetor 2019 në Parlamentin Europian, e cila mori mbështetjen e më shumë se 469 eurodeputetëve (143 kundër dhe 47 abstenuan).

Edhe pse në BE apo në SHBA rastet e dyshimeve për ndërhyje ruse në proceset elektorale janë vërtetuar prej vitesh, siç përmendet, edhe në rezolutë për të luftuar fenomenin, vendet anëtare ndalojnë plotësisht ose pjesërisht dhurimet e huaja për partitë politike ose kandidatët, aktorë të huaj gjejnë mënyra për t'i anashkaluar këto rregulla dhe, padyshim rasti i Frontit Kombëtar në Francë, siç përmendet në rezolutë, apo edhe pretendime për financime të partive të tjera në Europë, janë raste të cilat konfirmojnë domosdoshmërinë e ndërmarrjes së përbashkët nga vendet anëtare të BE-së, por edhe nga vendet e Ballkanit Perëndimor, të masave për të parandaluar çdo lloj financimi të huaj për partitë politike, qoftë në vendet e BE-së, qoftë në Ballkanin Perëndimor.

Në vitin 2018 BE-ja mori një vendim, që do ta quaja “*in extremis*” kur njoftoi zyrtarisht nisjen e luftës kundër dezinformimit (por, hapur nga Kremlin, thotë rezoluta), në përpjekje për të mbrojtur zgjedhjet e Parlamentit European 2019.

Mënyra e parandalimit të ndërhyrjeve të huaja për eurodeputetët është një iniciativë e përbashkët që shkon deri në forcimin e një task force të përbashkët, e cila quhet “east stratcom”.

Për të kaluar në rajonin e Ballkanit Perëndimor, pra të rajonit tonë, e cila na prek në mënyrë të drejtpërdrejt, prej vitesh, partnerët tanë strategjikë, por edhe studime të shumë instituteve kërkimore kanë evidentuar dhe faktuar praninë ruse në rajon, e cila nëpërmjet dezinformimit ka ndikuar në të paktën tre zhvillime politike rajonale: në referendumin e ndryshimit të emrit të Maqedonisë, në fazën e fundit të bisedimeve Kosovë-Serbi dhe në zgjedhjet e vitit 2018 në Bosnjë-Hercegovinë.

Është një studim i Fondit “Marshall”, i cili citon këto tre raste si raste të qasjes ruse në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Në bazë të studimit, nëpërmjet dezinformimit, narrativa e përhapur ruse janë lidhjet paraeksistuese të identitetit, histori e përbashkët dhe një mbështetje e pakushtëzuar politike ruse e shtirë në kohë.

Dezinformimi qëndron në faktin që zbehet dallimi midis opinionit dhe faktit, duke krijuar mosbesim në burimet e mëparshme të respektuara të informacionit dhe krijohet hapësirë për një narrativë antiperëndimore.

Sipas këtij studimi, po citoj: “Kjo narrativë është filtruar nëpër media tradicionale dhe sociale, si dhe aktorë vendorë politikë, kulturorë dhe ekonomikë. Nuk është e gjitha çështje e një axhende politike të imponuar nga lart poshtë, por ekziston edhe një mjedis politik i favorshëm, në mënyrë që përpjekje të tilla të mos rezistohen në mënyrën e duhur”.

Kam dëgjuar edhe diskutimet e brendshme, edhe këtu në Shqipëri, të cilat argumentojnë se Shqipëria është immune ndaj dezinformimit rus. Në fakt, është një argument pa bazë për sa kohë Shqipëria dhe shqiptarët kudo në rajon, në bazë të narrativës ruse janë objekt i saj. Sërish më pëlqen të citoj studimin e sipërpërmendur të Fondit “Marshall”, që thotë: “Ministria e Jashtme e Rusisë është duke kaluar narrativën që BE-ja dhe NATO-ja kanë miratuar krijimin e një Shqipërie të Madhe në rajon. Narrativa e Perëndimit ndërhyrës është ndërtuar gradualisht përmes deklaratave politike dhe përmbajtjes mediatike duke shfrytëzuar tensionet etnike lokale. Daljet proruse në rajon e kanë shfrytëzuar me këmbëngulje këtë argument në vitet e fundit. Një ilustrim i kësaj tendence është një titull që u shfaq në Sputnik në mars 2017 në fillim të krizës në Shkup “NATO-ja, e gatshme të shohë

gjakun në rrugët e Maqedonisë për projektin e Shqipërisë së Madhe”. Studiues të fushës, si Dimitar Beshev, paralajmërojnë se fushatat dezinformuese të Rusisë apo e aktorëve të tjerë në rajonin e Ballkanit Perëndimor nuk janë të drejtpërdrejta, por bazohen në një spektër të gjerë të instrumenteve diplomatike, duke u përfshirë, por jo të kufizuar në ndikimin e medieve, mbështetjen e publikut, në organizatat dhe liderët euroskeptikë, si dhe krijimin e OJQ-ve të ndryshme dhe shoqatave të qytetare, që luajnë role të rëndësishme në çështjet lokale”.

Ndërsa një studim tjetër i një fondacioni shumë reputativ, sikurse është “Konrad Adenauer”, në vitin 2018 argumenton se strategjia ruse bazohet në moton “përça dhe pushto”. Pushtimi është në sensin figurativ, pasi ajo që cenohet nga propaganda është ndërtimi i një narrative që të krijojë zhgënjim nga Perëndimi dhe integrimi më specifikisht.

Ndërsa një publikim i Friends of Europe, financuar nga BE-ja, identifikon *fake news* dhe dezinformimin si normalitet i ri në Ballkanin Perëndimor.

Nëse të dhënat e mësipërme i kombinojmë me faktin e një studimi të fundit të kryer në Institutin e Teknologjisë së Masaçusetes, dalim në përfundimin se informacionet e rreme dhe dezinformimi përhapen dukshëm, më shpejt, më thellë dhe më gjerësisht se e vërteta dhe së vërtetës i duhet gjashtë herë më shumë kohë për të arritur në 1500 njerëz në krahasim me përmbajtjen false.

Në këto kushte, duke u dakordësuar me faktin që vendi ynë nuk mund të jetë imun ndaj fenomenit të dezinformimeve dhe ndërhyrjeve të huaja në fushatat elektorale kam marrë iniciativën të depozitoj këtë projektrezolutë, e cila mbart titullin e njëjtë me atë të Parlamentit Europian për ndërhyrjet e huaja në proceset elektorale dhe dezinformimin në proceset demokratike kombëtare.

Mbetem në dispozicion të këtij komisioni për t’iu përgjigjur pyetjeve konkrete lidhur me draftin e paraqitur.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Balla!

Kolegu Bushati, fjala për ju si relator.

Ervin Bushati – Nisur nga rezoluta e Parlamentit Europian, datë 10 tetor 2019 “Mbi ndërhyrjen e huaj elektorale dhe dezinformimin në proceset demokratike kombëtare dhe europiane” dhe rezoluta e asamblesë parlamentare të Këshillit të Europës nr. 2255/2019 “Mbi shërbimin publik të medieve në kontekstin e dezinformimit dhe propagandës”, Grupi Parlamentar i PS-së vlerëson propozimin për shqyrtimin dhe miratimin në Kuvendin e Shqipërisë të projektrezolutës “Për ndërhyrjet e huaja në proceset elektorale dhe dezinformimin në proceset demokratike kombëtare”.

Arsyet e propozimit të kësaj projektrezolute janë si më poshtë:

- Konstatohet me shqetësim rritja në mënyrë eksponenciale e ndërhyrjeve të huaja në vendet anëtare të BE-së;
- Vërehet me shqetësim rritja e rasteve të dezinformimit të Rusisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor e më gjerë.
- Theksohet se ndërhyrja e huaj në zgjedhje minon të drejtën e shtetasve për të thënë fjalën e tyre në qeverisjen e vendit, direkt ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur, siç përcaktohet në deklaratën universale të të drejtave të njeriut dhe Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe se një ndërhyrje e tillë nga shtetet e tjera përbën shkelje të së drejtës ndërkombëtare edhe kur nuk ka përdorim të forcës ushtarake, kërcënim për integritetin territorial ose kërcënim për pavarësinë politike.

Prandaj, me anë të kësaj projektrezolute kërkojmë që institucionet kompetente të vlerësojnë ndërhyrjet e mundshme në legjislacion, marrjen e masave ligjore dhe administrative, të cilat kanë kompromentuar lirinë e shprehjes, mund të konsistojnë në ndërhyrjen nga platformat e medieve sociale me qëllim të etiketimit sistematik të përmbajtjes, rishikimin e algorizmave në mënyrë që t'i bëjnë ata sa më paanshme që të jetë e mundur dhe mbylljen e llogarive të personave që merren me veprimtaritë e paligjshme dhe që synojnë prishjen e proceseve demokratike ose nxitjen e gjuhës së urrejtjes.

Në fakt, edhe në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës janë miratuar dhe ne kemi mbështetur si Shqipëri mbi shtatë rezoluta që kanë të bëjnë me dezinformimin, përdorimin e gjuhës së urrejtjes apo rolin e politikës dhe të lidërshit për të parandaluar këto fenomene. Do të ishte naive të mendojmë që luftës i duhet vetëm ushtri për të pasur përballje. Ajo që po ndodh sot në botë, minimi i proceseve demokratike, minimi i procesit në besimin që kanë qytetarët si votues në proceset demokratike, argumenti fals se, sido që të shkojnë zgjedhjet, elitat politike që vendosin janë shumë të dëmshme, sidomos për demokracitë e reja, si Shqipëria.

Gjithashtu, ngacmimi i tensioneve etnike, sidomos në rajonin e Ballkanit, të cilat sponsorizohen nga fuqi, të cilat nuk janë në traktatin më të madh të paqes, NATO, patjetër që kanë interesa të tilla.

Do të ishte naive të mendojmë se lufta zhvillohet vetëm me mjete ushtarake si në shekujt e shkuar.

Dëmtimi i kredibilitetit në institucione, në sistemet ligjore, në sundimin e ligjit, patjetër që është një argument fals që sillet ndër këto zona për të bërë njerëzit të mos besojnë në institucione.

E treta është mosbesimi në institucionet e BE-së.

Është vërejtur edhe në studimet shkencore, të cilat janë paraqitur, që propaganda false e financuar në mënyrë të dëmshme, sidomos në rajonin e Ballkanit kërkon të minojë besueshmërinë e institucioneve të BE-së.

Nuk duhet të harrojmë se BE-ja është një kapital paqeje, stabiliteti dhe integrimi në Ballkanin Perëndimor.

Pavarësisht ngjarjeve politike të diplomacisë të momenteve të fundit, prania e BE-së është kapitali kryesor i paqes, i mirëqenies dhe integritit në Ballkanin Perëndimor, prandaj kërkojmë që kjo rezolutë të kalojë me mbështetjen e të gjitha palëve politike në Shqipëri dhe t'u hapë rrugën, si në të gjitha vendet e Europës, ashtu si edhe në Amerikë, një sërë ndryshimeve në legjislacion, por edhe në mënyrën e të menduarit, edhe në trajtimin nëpërmjet edukimit të asaj të quhet “dezinformim”, “*fake news*” apo ndërhyrje në proceset demokratike nëpërmjet mënyrave, të cilat nuk janë nga ato konvencionale dhe ne kujtojmë se mund të jemi imunë. Vetëm fakti se jemi proamerikanë nuk na bën imun ndaj virusit të përçarjes, dezinformimit apo të lajmeve të rreme.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, koleg!

Kalojmë te pyetjet.

Kolegu Gjoni fjala për ju.

Ralf Gjoni – Së pari kam shumë vjet që merrem me politikën e jashtme dhe nuk kam parë në karrierën time një argumentim kaq të dobët dhe kaq të pabazuar për një çështje kaq madhore, siç janë financimet e huaja në fushatat elektorale dhe sidomos kur bëhet fjalë për Rusinë, që është çështje globale.

Ndërsa ndaj disa nga shqetësimet, më bezdis fakti që juve përmendni këtu një konventë të vitit 1966. Pastaj përmendni Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Këtu bëhet fjalë për përfshirje ruse dhe të huaj, që do të thotë për përdorimin e shtetasve shqiptarë në financime të paligjshme gjatë fushatave elektorale. Pra, kemi të bëjmë me akte që përbëjnë vepra penale dhe dënohen deri me burg, siç është rasti i disa individëve në SHBA të administratës “Tramp”. Bëhet fjalë për diçka madhore, nëse do ta marrim në konsideratë në parlament këtë: përse nuk ka një relacion apo një informacion nga Shërbimi Informativ dhe nga shërbimet respektive që merren me këto punë? Ne nuk mund të bazohemi te një studim i *Konrad Adenauer*-it apo *Friends of Europe*, që janë studime anekdotale, të pabazuara pa pasur një informacion zyrtar nga Shërbimi Informativ i Republikës së Shqipërisë. Pyetja ime është shumë e thjeshtë: përse nuk

ka një informacion nga SHISH-i? A keni ju një informacion nga drejtori i SHISH-it për këtë çështje?

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Gjoni!

Po, zoti Ministër.

Ditmir Bushati - Faleminderit, zonja kryetare!

Kam një pyetje që besoj se është qendrore për temën e diskutimit dhe për pozicionet që mund të kemi ne si deputetë: a është konsultuar kjo iniciativë me qeverinë shqiptare? Nëse po, para çdo lloj vendimmarrje, ne duhet të kemi një opinion të firmosur nga qeveria shqiptare në lidhje me këtë çështje. E them nga qeveria shqiptare, sepse është një lloj sikur dikush nga ne të marrë një nismë, të propozojë që tvsh-ja në Shqipëri të hiqet fare dhe të mos ketë një opinion nga qeveria shqiptare, e cila është gardiane e buxhetit. E them këtë gjë, sepse qeveria shqiptare është institucioni përgjegjës që koordinon disa institucione qoftë ato që janë brenda sferës së drejtpërdrejtë të saj, por edhe institucione të tjera, me të cilat ajo bashkëpunon. Për mua kjo është pyetja themelore dhe duhet të kemi një dokument të certifikuar nga ana e qeverisë shqiptare që të bëjmë një diskutim më pas me dyer të mbyllura në bazë të të gjitha dispozitave që përcaktojnë Kushtetuta e Shqipërisë dhe ligji “Për trajtimin e informacionit të klasifikuar”. Pse e them këtë? Po dal të pyetja e dytë: zoti Balla ju e dini se BE-ja funksionon mbi parimin e *subsidiaritetit*. Mund t’ju them se që në titull kemi një gabim, por nuk dua t’i hyj fare këtij diskutimi, sepse pa pasur qëndrimin e qeverisë shqiptare nuk dua që ky komision i nderuar apo parlamenti të futet nëpër ujëra të turbullta. Unë e kam bërë kërkimin për këtë gjë dhe më rezulton se asnjë prej parlamenteve kombëtare nuk ka shkuar në këtë proces, sepse natyra e BE-së është e ndryshme dhe kur flasim për procese demokratike kombëtare mbi bazën e parimit të *subsidiaritetit* vetë Parlamenti Europian u bën thirrje vendeve anëtare. Po kështu na lind e drejta që të kemi një informacion nga qeveria shqiptare se cilat janë vendet e Ballkanit Perëndimor që e kanë marrë një nismë të tillë, që na shtyn ne të marrim një nismë të tillë. Mos harroni se vetëm në pak javë Shqipëria zyrtarizon për herë të parë marrjen e kryesisë së OSBE-së. Ne jemi një vend trojkë me Italinë dhe me Sllovakinë që në momentin kur jemi futur në *kuatriga* në dhjetor të vitit 2018, kur na është besuar njëzëri dhe vendet që përmenden në këtë rezolutë, po ju them se kanë një peshë specifike jo vetëm në OKB si anëtarë të Këshillit të Sigurimit, si fuqi nukleare, por janë edhe në OSBE, ne kemi marrë disa zotime aty. Prandaj si Komisioni për Politikën e Jashtme, jam i bindur se te materiali, tek opinionin që do të vijë nga qeveria duhet të dimë edhe qëndrimin e Sllovakisë, të Italisë

si vende në trojkë, sepse janë detyrimet tona ndërkombëtare dhe për sa kohë ne jemi në trojkën e OSBE-së.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, këtu bie dakord me kolegun Gjoni, për të gjithë ata që janë marrë me përkthimin, në disa raste për fat të keq më duhet të them, jokorrekt të rezolutës së Parlamentit European. Rezoluta e PE-së citon mbi 20 dokumente, që janë dokumente të Komisionit European dhe pasi i citon dokumentet e BE-së, të agjencive të specializuara të KE-së, të agjencive të specializuara të BE-së, të konkluzioneve të Këshillit të BE-së, pra janë 20 dokumente, ku nuk përmendet vetëm Rusia, por aktorët shtetërorë, joshetërorë dhe në një masë të madhe, rendit edhe disa fakte se si instanca të specializuar i kanë dedektuar këto ndërhyrje, më pas vjen me tekstin e rezolutës. Për shembull, konventa që referoi zoti Gjoni, mund t'i them kujtdo këtu se bëhet fjalë për paktin e OKB-së për të drejtat civile dhe politike, që të mos lëmë nam, sepse të gjithë ata juristë që janë marrë me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut në këtë vend, të paktën të mos qeshin me ne. Keni thënë këtu për Kartën e të Drejtave të Njeriut të BE-së, ne nuk jemi vend anëtar i BE-së, nuk ka asnjë vlerë për ne ky dokument. Keni thënë për traktatin e BE-së, ne nuk jemi anëtarë.

Hajdeni t'i referohemi Marrëveshjes së Stabilizim –Asociimit! Hajdeni t'i referohemi Kushtetutës! Ka disa nene për formën demokratike të shtetit, për pluralizmin politik, për lirinë e votës, për laicitetin, sepse për mua problem kryesor në propagandë këtu janë aktorët joshetërorë. Për shkak të detyrës sime si ish-ministër, sepse është kollaj kur kryetarja e Komisionit, na drejtohet: “Ministër”, kur ka qenë vetë 4 vjet ministre e Mbrojtjes, edhe për shkak të dokumenteve që ka lexuar e ka atë informacion për të kuptuar se cili është niveli kritik që ne duhet të përballojmë. Pyetja ime e drejtpërdrejtë është: a është kjo rezolutë në përputhje me Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të Shqipërisë? Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Shqipërisë është dokumenti bazë mbi të cilin mbështetet doktrina e sigurisë kombëtare, është votuar njëzëri në Kuvendin e Shqipërisë, dokumenti i fundit është miratuar më 31 korrik të vitit 2014, është votuar nga të gjitha partitë në Kuvendin e Shqipërisë, sepse në këtë rezolutë mungon një komponent kritik që është prania e Shqipërisë në NATO. Nëse në këtë rezolutë ju sillni 3 elemente: ndërhyrjen në zgjedhje, sulmet kibernetike dhe në infrastrukturën dixhitale, si dhe dezinformimin, ju them se NATO dhe ne kemi qëndrime, fjalime, të Kryeministrit, të ministrit të Jashtëm, të ministrit të Mbrojtjes, të Shefit të Shtabit, të ambasadorëve e të tjerë dhe kemi këtë dokument që është miratuar nga të gjithë ne së bashku, që përcakton klasifikimin e risqeve në Republikën e Shqipërisë. Prandaj po ju them se na duhet një qëndrim nga qeveria shqiptare, që është dokumenti i Strategjisë së

Sigurisë Kombëtare. Nuk duhet të vazhdojmë më tej me pyetjet, sepse ju garantoj se e kam bërë kërkimin e plotë për këtë çështje. Mund t'ju them se në rezolutë nuk thuhet sesa është ajo në përputhje me dokumentin e politikave për sigurinë kibernetike të miratuar nga qeveria shqiptare, sa është në përputhje me strategjinë për sigurinë kibernetike, sa është në përputhje me axhendën dixhitale të Shqipërisë 2014-2020. Meqenëse edhe relatori tha se nuk jemi imunë, po ju them se qeveria shqiptare është në lartësinë e detyrës kur vjen puna për këtë çështje, sepse është anëtarësia në NATO që na bën të jemi *alert* për këtë çështje. Sa është në përputhje me ligjin "Për sigurinë kibernetike" që kemi miratuar këtu së bashku, ligji nr.2 i vitit 2017?

Ju lutem shumë, të marrim opinionin e specializuar, sepse nën qeverinë shqiptare është edhe SHISH-i, edhe SHIU, edhe ALCIRT-i, AKEP-i, AMA, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik të Sigurisë Kibernetike, Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike. Po ju them se qeveria ka përgatitur edhe Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2019-2025. Janë të gjitha këto elemente, të cilët duhet t'i kemi shumë të qarta përpara se t'i japim një formë substanciale diskutimit.

Mimi Kodheli - Faleminderit, ministri Bushati!

Mendoj se është fjala për ju kolegu Balla, përpara se sa të dëgjojmë pyetjet e kolegëve të tjerë.

Taulant Balla - Faleminderit, e nderuar zonja kryetare!

Për sa i përket konventës së cituar nuk janë cituar të gjitha dokumentet mbi të cilat është referuar Parlamenti Europian, për një arsye që të paktën ju e dini, që ne jemi aderues në atë konventë dhe e dini se nuk janë cituar të tjerat, në të cilat nuk jemi dhe dokumentet e BE-së që citoi kolegu Bushati. Ndoshta nga mungesa e eksperiencës, por nuk jemi komisioni përgjegjës për këtë çështje, pasi Komisioni përgjegjës është Komisioni për Sigurinë Kombëtare, i cili është i detyruar nga Rregullorja e Kuvendit që t'i drejtohet qeverisë për të marrë opinionin për këtë çështje.

Në raportin përfundimtar të Komisionit të Sigurisë Kombëtare është e detyruar që të përfshihet komenti i qeverisë, pozicioni i qeverisë shqiptare. Ndoshta nuk e dini, por Republika jonë është republikë parlamentare, e drejta e një deputeti për të propozuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

Kush ju jep të drejtën të ndërprisni fjalën?

Mimi Kodheli - Kolegu Gjoni, ju lutem, nuk jua kam dhënë fjalën!

Kolegu Gjoni, ju tërheq vërejtjen!

Taulant Balla – Ju thatë se ky është prezantimi më i dobët që keni dëgjuar nga eksperiencia juaj 37 -vjeçare. Në eksperiencën tuaj 37 -vjeçare thashë se ndoshta nuk e din se procedura parlamentare është ajo që thashë më lart.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, nuk kam asnjë dyshim.

Për sa i përket informacionit të klasifikuar në Komisionin për Sigurisë Kombëtare kushdo që do të jetë i pajisur me certifikatën e posaçme të sigurisë, ku do të jenë të ftuar pa dyshim edhe përfaqësuesit e organeve të specializuara, të cilët ju i cituat këtu, është domosdoshme të jenë të ftuar. Komisioni për Sigurinë Kombëtare duhet të marrë edhe vlerësimin e tyre, por kryhet atje ku është e sanksionuar në Rregulloren e Kuvendit, në komisionin përgjegjës. Nëse ju keni propozime konkrete dhe zoti Bushati, me të drejtë kishte disa propozime konkrete për t'u pasuruar kjo rezolutë dhe me çështje që lidhen me sigurinë kibernetike. Dje dhe sot kemi një diskutim shumë të gjerë dhe produktiv në Kuvendin e Shqipërisë me parlamentet e të gjitha vendeve të Europës Juglindore për sigurinë kibernetike. Në diskutimet e djeshme ra në sy fakti që të gjitha vendet e Europës Juglindore ndajnë të njëjtin shqetësim me atë të përmendur në draftrezolutën e propozuar, që ka një tentativë ndërhyrjesh në lëmin e sigurisë së informacionit, pra të informimit. Ajo që dua t'ju them është që të mos bëjmë sikur fshihemi pas gishtit, kur sot në Prokurorinë e Republikës së Shqipërisë ka një hetim ndaj një subjekti elektoral të një partie politike, lidhur me financime me burime të dyshimta sipas një medie reputative amerikane, sikurse është “*Mothers Jones*” pas së cilës qëndrojnë financues rusë. Kjo draftrezolutë është e vonuar. Në momentin që u bë publike, ku një parti politike e dyta për nga madhësia në Shqipëri, vendoset nën akuzë, kryetari i saj për financime të dyshimta ruse, pa dyshim që Kuvendi i Shqipërisë duhet të ndërmarrë hapat e nevojshëm. Thirrja që bëhet përmes kësaj rezolute është që në ligjin “Për financimin e partive politike”, në Kodin Zgjedhor, në kapitullin “Për financimin e fushatave zgjedhore” të marrim masa dhe të rrisim kapacitetet kontrolluese të çdo lloj financimi, i cili kalon përmes hullive që ne kemi lënë në këto raste.

E kemi ligjin “Për financimin e partive politike”? E kemi. Si ka mundësi që Partia Demokratike merr nga Biniatta Trade 500 mijë dollarë për lobingut e saj politik jashtë kufijve të Shqipërisë? Atëherë, kjo tregon se legjislacionin nuk e kemi në rregull, se po ta kishim në rregull, do ta kishin kapur organet tona ligjzbatuese. Nuk e kapën organet tona ligjzbatuese, por investigimi i një reviste amerikane, sikurse është “*Mother Jones*”.

Padyshim, unë nuk kam ekskluzivitetin e përmbajtjes së këtij teksti. Kur kthehemi te parimet që përmendi zoti Bushati, Parlamenti European, edhe në raste të tjera, për ne është një

referencë të dobishme për një problem që e kemi. Nuk besoj se ndokush mund të thotë se ky problem nuk ekziston. Nëse ju thoni se ky problem nuk ekziston, kjo është çështje e kapacitetit për ta analizuar situatën në vend, por rajoni i Ballkanit Perëndimor është një rajon që ne e njohim fare mirë. Unë ju përmenda më sipër raste, sikurse referendumi që u bë vitin e shkuar në Maqedoni. Po ashtu edhe raste të tjera.

Ky është një draft. Unë mirëpres që Komisioni i Politikës së Jashtme, me këtë komponentë shumë të lartë ekspertësh që ka, ta përmirësojë, por të biem dakord me njëri-tjetrin në lidhje me nevojën që kemi për të bërë të njëjtën qasje me Parlamentin Europian. Rregullimet janë të mirëpritura, dhe padyshim që mund të jepni edhe ju propozimet tuaja.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Balla!

Pyetje nga zonja Hajdari, e më pas nga zoti Shtjefni.

Zonja Hajdari, fjala është për ju.

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja kryetare!

Pa dashur të përsëris fjalët e kolegëve, zotit Gjoni dhe Zotit Bushati, unë jam plotësisht dakord me të gjitha çështjet që u ngritën.

Ju zoti Balla, e dini mirë se pse sot Bashkimi Europian ka bërë një rezolutë të tillë, në nivel ndërkombëtar, lidhur me realitetin krejt ndryshe që ka Shqipëria. Pra, Bashkimi Europian e ka bërë këtë projekt apo rezolutë për shkak se këto vende i respektojnë totalisht konventat që ju keni përmendur këtu. Ndërkohë, edhe pse jemi anëtarë të disa prej këtyre konventave, pra edhe Konventës Ndërkombëtare të OKB-së, që është ajo e të drejtave civile e politike. Ju e dini fare mirë se ne nuk jemi në lartësinë e vendeve të Bashkimit Europian, kur bie fjala për respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë këtu edhe të drejtën për të përzgjedhur përfaqësuesit tanë. Gjendemi akoma tek çështjet bazë, ato elementare.

Ajo që dua të them, është se kjo vjen... Domethënë, ndërhyrjet ruse janë bërë problem për shkak se është krijuar një lloj fenomeni në Bashkimin Europian, i liderëve që janë autoritarë, që ka të bëjë me ksenofobinë.

Këtë fenomen, ne e kemi pasur gjithmonë, Ju s'keni çfarë...

Mimi Kodheli – Zonja Hajdari, pyetjen, të lutem!

Rudina Hajdari – Më vjen keq, por ky është thelbi.

Mimi Kodheli – Pyetjen, të lutem!

Rudina Hajdari – Ajo që dua të them unë, zoti Balla, është: pse merremi me një rezolutë, e cila është huazuar krejtësisht nga Bashkimi Europian, që nuk i përket fare realitetit tonë? Sa i përket edhe rastit që ju sapo përmendët, në lidhje me kryetarin e Partisë

Demokratike, ai është rast me të cilin merret prokuroria dhe nuk ju takon juve të ndërhyjni në punën e organeve të drejtësisë. Lëreni të vazhdojë procesin e hetimit, dhe pas përfundimit mund të keni të drejtë të flisni. Në kushtet e sotme, me këtë rezolutë, më vjen keq, por ju po bëni një rezolutë kundër shefit tuaj. Po ta shohësh në thelb, kjo rezolutë është për një shef, për një lider që është autokrat në Shqipëri.

Pse duhet të kesh ti frikë nga ndërhyrjet ruse? Pse duhet të kesh frikë? Kjo është ajo që desha të thosha, se këtu jemi në një realitet, që s'kemi nevojë të frikësohemi, sepse në 98 % të tij populli shqiptar është me Bashkimin European dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Problemin kryesor e kemi me liderët tanë, nuk e kemi fare me ndërhyrjet ruse. Kësisoj, ju lutem, le të jemi sa më seriozë. Çështjet që ngriti zoti Bushati janë me vend dhe nuk kam pse t'i përsëris, por vërtet nuk e shikoj të nevojshme një rezolutë të tillë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Hajdari!

Zoti Shtjefni, pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Balla, do të bëjë pyetje edhe zoti Shtjefni, e më pas fjala për ju.

Zef Shtjefni – Unë dua të di një fakt konkret. Të paktën në këto tri zgjedhjet e fundit, a ka kush ndonjë fakt konkret, që në Shqipëri ka pasur ndërhyrje ruse? Pra, po e marrim që nga zgjedhjet e vitit 2013 e këndeje, a keni ndonjë fakt konkret, apo janë gjëra të përgjithshme?

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Zoti Balla, fjala për ju. Pastaj zoti Karamelo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Karamelo, të lutem!

Ligoraq Karamelo – Faleminderit, zonja kryetare!

Do të jem konkret në pyetje, pa bërë shumë komente.

Po flitet shumë për rrezikun e ndërhyrjes ruse, e me të drejtë, se ky është një shqetësim mbarëkombëtar e më gjerë, por unë desha të dija: a mos është e nevojshme të përqendrohemi edhe tek ndërhyrje të tjera? A ka edhe shtete të tjera që tentojnë të ndërhyjnë në Shqipëri, sa u takon zgjedhjeve? Sepse, me sa di unë, nëse marrim infrastrukturën e ndërhyrjes, Rusia është shumë më larg se sa vende të tjera, vende të cilat janë ulur këtu këmbëkryq, që kanë akses shumë më të madh për ndërhyrje, e që mbase edhe kanë ndërhyrë më përpara.

Pyetja e dytë është: a e shikoni ju futjen e 5G-së si një rrezik në zgjedhjet e ardhshme elektorale, në lidhje me mundësinë e ndërhyrjen në procesin e zgjedhjeve?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zoti Balla, fjala për ju.

Taulant Balla – Së pari, dua ta theksoj se ky draft është një shprehje e vullnetit, në rast se do të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë, të vijimit të një politike 100 % në të njëjtën linjë me atë të Bashkimit Europian. Vetë rezoluta e Bashkimit Europian, edhe në diskutimet e zhvilluara në Parlamentin Europian, është shprehur që kjo qasje është e domosdoshme sa për 28 vende anëtare të Bashkimit Europian, po ashtu, po aq edhe për vendet aspirante për t'u anëtarësuar në Bashkimin Europian, qofshin këto vende të Ballkanit Perëndimor apo të fqinjësisë së Bashkimit Europian.

Dua t'ju ftoj që të bashkëndani me mua, në cilësinë e propozuesit, nevojën që ne kemi si Kuvend i Shqipërisë, që të bashkohemi për të dyja këto çështje. Qoftë ndërhyrjet e huaja në proceset demokratike, qoftë dezinformimi, përbëjnë një prej betejave më të rëndësishme të demokracive kudo në Europë.

Kancelarja Angela Merkel, në përfundim të zgjedhjeve të vitit 2017, me të drejtë tha se fushata elektorale që sapo mbyllëm përgjatë shtatorit 2017 nuk ishte një betejë elektorale ndërmjet ideve, ideologjive, por ishte një betejë me dezinformimin.

Në zgjedhjet e vitit 2021 ne nuk do të kemi një betejë me dezinformimin, por do të kemi një betejë mes ideve, projekteve politike, skuadrave. Besoj se çdo masë që do të ndërmarrë Kuvendi i Shqipërisë pas kësaj rezolute, në betejën kundër lajmit të rremë, kundër dezinformimit... Sepse besoj se çdokush prej jush në familjet tuaja bashkëndan me mua nevojën e marrjes së masave konkrete kundër, më falni për shkrehjen, kundër çdo idioti që guxon të botojë lloj-lloj lajmi, që i nxjerr nga shtëpia nënat me fëmijë në 11 të natës, nga frika se do të bjerë tërmet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, nuk jam në provim këtu, që të më jepni ju notën.

E dyta, për sa i përket asaj që thashë më lart, shprehjes së vullnetit tonë për të qenë në të njëjtën linjë me qasjen e Parlamentit Europian, e thashë, kjo është një shprehje vullneti, dhe besoj se në lidhje me këtë shprehje vullneti secili prej jush, sa kohë që nuk do të ishin kamerat këtu, padyshim që do të binit dakord.

Sa i takon asaj që tha i nderuari zoti Shtjefni, pak minuta më parë unë ju përmenda një rast.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Padyshim, padyshim.

Rasti i investiguar nga revista “Mother Jones” është një rast që ka ndodhur përgjatë fushatës zgjedhore të vitit 2017. Pagesa e fundit e dyshuar, nga burimet ruse, është e datës 10 qershor 2017, pra kur unë dhe ju ishim së bashku në fushatë elektorale.

Zoti Karamelo, shumë faleminderit për pyetjen tuaj! Është një pyetje me rëndësi, sepse padyshim që nuk është vetëm Rusia, një aktor që citohet nga rezoluta e Parlamentit Europian. Në pikën ‘d’ ne kemi renditur dhe aktorë shtetërorë dhe joshetërorë nga vende të treta, pra edhe vende të tjera.

Në fund, dua të bëj një sqarim të një mungese ose të një dezinformimi që ka lindur në lidhje me atë që quhet 5G. Rrjeti 5G është rrjeti më i avancuar i transmetimit të të dhënave, me një shpejtësi tërësisht të pakrahasueshme me rrjetet e mëparshme 4G, 3G e të tjera. Aktualisht në Europë, ky rrjet është funksional në Gjermani dhe vetëm në zonën e Berlinit, por vijon shtrirja e saj në pjesë të tjera të Gjermanisë. Ka filluar eksperimentimi edhe në zona të tjera. Madje, një prej operatorëve në Shqipëri ka lançuar idenë, le të themi. Nuk kam informacion që ka filluar ndërtimin e rrjetit, sepse ndërtimi i rrjetit është proces që kërkon një investim shumë të madh. Në Shqipëri, ndërtimi i këtij rrjeti nga vetëm një operator kërkon një vlerë prej afro 100 milionë eurosh, për të garantuar një rrjet të qëndrueshëm të transmetimit të të dhënave.

Nuk duhet të ngatërrojmë rëndësinë që ka ndërtimi i rrjetit 5G dhe kompanitë e dyshimta që ndërtojnë këtë rrjet. Dhe kur them të dyshimta, duhet të jemi të kujdesshëm në termin e përdorur, pra kompani të cilat, sikurse me të drejtë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ambasada e tyre këtu në Tiranë citojnë, mund të përdorin të dhënat e transmetuara në këtë rrjet për qëllime të tjera. Pastaj, me “të tjera” secili prej jush le ta kuptojë se cilat janë.

E rëndësishme është që ky rrjet, tek i cili të paktën në dhjetë vitet e ardhshme, të gjitha shoqëritë tona do të *upload*-in, do të vendosin të gjitha sistemet dhe të dhënat e domosdoshme të jetës së përditshme, të dhënat e sigurimeve shoqërore, të dhënat bankare e çdo të dhënë tjetër, duhet të jenë i ndërtuar nga kompani, në lidhje me të cilat zonja Kodheli mund t’ju japë informacion sa të doni, që kanë certifikimet e domosdoshme.

Jemi anëtarë të NATO-s, synojmë dhe do të jemi anëtarë të Bashkimit Europian. Padyshim, do të jemi, por duhet të sillemi njësoj si...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pa dyshim që sot.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Fjalën e kanë kërkuar zoti Shameti, zoti Gjoni dhe pastaj deputeti Bushati.

Fillimisht, fjalën e ka zoti Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Në radhë të parë, unë dua të shpreh vlerësimin më të madh për projektrezolutën e paraqitur sot në Komisionin për Politikën e Jashtme, si dhe vlerësoj ndërhyrjet e kolegëve të nderuar në këtë komision. Por, me gjithë relatimin, edhe pa qenë relatorë, të disa kolegëve të nderuar këtu, do të mirëprisja më shumë ndërhyrje specifike ose sugjerime specifike teknike për ta përmirësuar si projektrezolutë. Mbetemi të hapur që deri në variantin përfundimtar dhe miratimin përfundimtar në Komisionin për Politikën e Jashtme t'i kemi të tilla këto ndërhyrje.

Për sa i takon skepticizmit të disa kolegëve në lidhje me ndërhyrjet e huaja qoftë në procesin elektorale, qoftë në përgjithësi, në rastin më të keq dua t'ju siguroj se kujdesi i tepërt nuk ka vrarë njeri. Kështu që, edhe kjo pikëpamje, sado modeste, është për t'u vlerësuar si projektrezolutë, jo që realisht rezoluta e Parlamentit Europian, që është kaluar së fundi, dhe gjuha që kjo projektrezolutë përmban sot dhe që paraqitet për miratim në Komisionin për Politikën e Jashtme është serioze dhe i mbart të gjitha ato elemente, për të cilat u kalua edhe në Parlamentin Europian.

Për sa i takon identifikimit të ndërhyrjeve të huaja apo problematikave që ka në lidhje me këtë proces, duke qenë se ne jemi komision për dhënie mendimi këtu, ftoj kolegët të vijnë ta ndjekin procesin edhe në Komisionin e Sigurisë Kombëtare, ashtu sikurse zoti Balla e paraqiti, edhe ata, të cilët kanë certifikatën e sigurisë, mund të kërkojnë informacion më të detajuar shtesë për sa më sipër.

Në këto kushte, nuk më mbetet gjë tjetër veçse t'i ftoj të gjithë kolegët e nderuar të këtij komisioni që ta mbështesim unanimisht këtë projektrezolutë dhe të japim kontributin tonë edhe atje ku mendohet se mund të bëjmë ndonjë përmirësim, në mënyrë që të kjo rezolutë të gjejë gjuhën perfekte në përputhje edhe me rezolutën e Parlamentit Europian.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Shameti!

Fjalën e ka kolegu Gjoni.

Ralf Gjoni – Faleminderit, zonja kryetare!

Atëherë, zoti Balla, ne këtu jemi Komisioni për Politikën e Jashtme dhe jo Asambleja Kombëtare e Partisë Socialiste. Ndaj, ju lutem, vlerësoni edhe shqetësimin e kolegëve të nderuar të këtij komisioni, të cilët kanë dy-tre vjet eksperiencë në politikën e jashtme, jo 37

vjet sa ju, për të ngritur disa çështje që janë shqetësuese për të gjithë popullin shqiptar dhe jo vetëm për Partinë Socialiste.

Unë dua t'i marr një nga një disa nga pikat që ju keni shkruar ose që keni propozuar në këtë draftrezolutë. Ju thoni se financimi rus është problem i madh. Dakord, le t'i marrim një nga një. Cila është këmba e Ruisë në Ballkan? Të gjithë e dimë se është Serbia. Me kë po merret Kryeministri shqiptar sot, menjëherë pas refuzimit të Bashkimit European për hapjen e negociatave për anëtarësim? Vizita e parë që bëri ishte në Beograd. Për çfarë foli? Për minishengenin; mesazh shumë i qartë politik për sa i përket orientimit të Shqipërisë drejt një aleati tradicional historik dhe të betuar të Ruisë në Ballkan.

Ju flisni për Rusinë. Unë kam informacione anekdotale për financime ruse të disa portaleve medietike në Shqipëri, por nuk e provoj dot. Për këtë kemi nevojë për institucione shqiptare dhe jam totalisht dakord me ish-ministrin Bushati kur thotë se këtu duhen mobilizuar të gjitha strukturat shtetërore, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, gjithashtu, por edhe strukturat e shërbimeve për të marrë një informacion shterues, tërësor, me qëllim që ta bazojmë këtë rezolutë mbi fakte dhe jo mbi propagandë.

Tani, ju flisni për Rusinë dhe në rezolutë përmendni se liria e fjalës dhe e të shprehurit, si dhe mbrojtja e të dhënave personale janë në thelb të shoqërisë demokratike. Le të mbetemi pak te mbrojtja e të dhënave personale.

Më falni, zoti Balla, por kush i ka dy prej kompanive më të mëdha celulare dhe të telefonisë në Shqipëri? Rusia, apo Turqia? Kush e ka kompaninë tjetër (është një vend tjetër ballkanik), që serverin e të dhënave personale të shtetasve shqiptarë e ka transferuar në mënyrë të qartë antikushtetuese dhe antiligjore jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë? Kush e ka? Nuk po e përmend, pasi këto janë çështje që duhen hetuar nga drejtësia.

Në rezolutë ju përmendni edhe dezinformimin, por kush dezinformon sot, ne që jemi opozitarë pa media, pa financime, pa lidhje me krimin e organizuar, apo ata që sot janë maxhorancë?

Gjithashtu, në rezolutë përmendni ndërhyrjen e huaj. Më falni, zoti Balla, por a nuk ju mjaftojnë raportet e Bashkimit European, kontaktet tuaja si personale, ashtu edhe institucionale me Bundestagun, si dhe raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit për sa i përket ndërhyrjes së krimit të organizuar në proceset elektorale të Shqipërisë? Cila është më rrezik sot, Rusia, Turqia apo paratë e drogës të lidhura me Italinë, me *Ndraghetta*-n në Reggio Calabria, dhe me ata përfaqësues të partive politike, duke përfshirë edhe Partinë Socialiste, që kapen në përgjime për blerje vote me para të pista? Cila e ka fajin këtu, Rusia? Ndërkohë, nga ana tjetër, ju nuk përmendni vende të tjera (mirë e tha kolegu im), kemi Iranin

super të investuar në Shqipëri për të kryer aktivitete të paligjshme dhe për ndërhyrje nëpër portale, nëpër medie, për investime me politikanë edhe të partisë suaj... Nga të dyja anët e Iranit (jo vetëm Irani si shtet, por edhe nga ana e disa përfaqësuesve të tjerë të vendosur në Shqipëri)... A nuk quhet ndërhyrje e huaj kjo?

Ju shkuat dhe i ngritët lapidar Turqisë dhe Erdoganit në mes të parkut të Tiranës dhe ju bëka përshtypje financimi rus në fushatat elektorale?!

Zoti Balla, unë mendoj që ne duhet të jemi seriozë pranë këtij komisioni, madje ju sugjeroj tejet miqësisht, do të doja të ndaja bashkë me ju shqetësimin tonë si deputetë për ndërhyrjet e huaja, por ne nuk mund të flasim për ndërhyrjet e huaja në rezolutë, në qoftë se nuk flasim për ndërhyrje të paligjshme, financime të paligjshme kriminale në fushatat elektorale. Nuk mund të rrimë jashtë kësaj tematike në këtë rezolutë, madje unë ju ftoj ta tërhiqni këtë rezolutë, ta ridraftoni. Ne jemi të gatshëm të japim bashkëpunimin tonë për të ridraftuar një rezolutë gjithëpërfshirëse (tërësore), që adreson problemet reale të bazuara mbi fakte dhe pastaj ta risillni për mendim në komision për ta kaluar në parlament bashkërisht.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Gjoni!

Përpara se t'ia jap fjalën ish-ministrit Bushati dhe më pas kolegut Bushati, më lejoni t'ju risjell në vëmendje, kolegë të nderuar, se flasim për një projektrezolutë, e cila ka të bëjë me ndërhyrjet e huaja në proceset elektorale dhe me dezinformim në proceset demokratike në përgjithësi. Kur flasim për ndërhyrjet e huaja, kjo nuk është një rezolutë kundër Rusisë (Federatës Ruse), absolutisht jo, por është kundër ndërhyrjeve të huaja dhe janë dy gjëra të ndryshme ose...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, por nisur nga emërtimi i projektrezolutës, kjo ka të bëjë me ndërhyrjet e huaja në proceset elektorale dhe të dezinformimit në proceset demokratike kombëtare, që jo domosdoshmërisht janë vetëm proceset parazgjedhore, zgjedhore ose paszgjedhore, por në përgjithësi proceset demokratike kombëtare përmbledhin më shumë sesa kaq.

Fjalën e ka ish-ministri Bushati dhe pastaj kolegu Bushati.

Ditmir Bushati – Shumë faleminderit, zonja Kodheli, edhe me qartësimin që bëtë, sepse u fol këtu për proceset demokratike dhe është e rëndësishme të kuptojmë se proceset demokratike janë më të gjera sesa thjesht procesi zgjedhor!

Kur flasim për ndërhyrjen e huaj, zoti Balla, si propozues i kësaj nisme, duhet të jemi, insistoj ta them, shumë herë të kujdesshëm dhe të vetëkontrolluar, pasi që në vitin 1990 kemi lejuar, kemi pranuar dhe kemi zgjedhur sistemin e demokracisë liberale. Qoftë Konrad

Adenauer, qoftë *Friedrich-Ebert-Stiftung*, qoftë fondacioni “Soros”, qoftë NDI-ja, IRI-ja, *Westminster Foundation*, për të mos vazhduar më tej me Komisionin Europian, me Bankën Botërore, me FMN-në, me Bundestagun gjerman për rezolutën që bën për Shqipërinë e të tjera, të gjitha mund të keqpërdoren dhe të mund të konceptohen më pas si ndërhyrje e huaj, sepse, në fakt, është një ndërhyrje nga një palë tjetër, pra nuk është një proces shqiptar. Ndërkohë, procesi zgjedhor është më i kufizuar sesa thjesht procesi demokratik dhe insistoј sërish të them se ka përkufizime për këto gjëra.

Insistoј, unë nuk e mora përgjigjen e pyetjes që shtrova: se sa kjo projektrezolutë është në përputhje me strategjinë e sigurisë kombëtare? Më besoni, në asnjë vend të botës nuk ngrihet një deputet, aq më tepër i maxhorancës, dhe të ndryshojë rregullat që janë të skalitura. Doktrinën e sigurisë kombëtare nuk e ndërron dot Presidenti i Republikës, nuk e ndërron dot Kryeministri, e jo më të bëhemi ne një grup deputetësh, sado që mund të themi se jemi demokraci parlamentare dhe se e ndryshojmë shkallën e rrezikut dhe i riklasifikojmë ndryshe aktorët. Nuk ka asnjë parlament në Europë, në qoftë se do ta gjeni një, ju lutem, silleni, që të merret me emra shtetesh. Nuk ka. Po ju them: nuk ka asnjë në Ballkanin Perëndimor, as ato shtete që me të drejtë ju iu referuat, të cilat kanë vuajtur nga ndërhyrjet apo nga influencat. Për të mos thënë se na takon për të bërë një diferencim, që është konceptual dhe me pasoja në praktikë, mes influencës ruse apo atyre që i konsiderojmë si aktorë të tretë, por që, tradicionalisht, kanë pasur një interes për Ballkanin Perëndimor, si Rusia, Kina, Turqia, vendet e Gjirit Persik e të tjera dhe ndërhyrjes së huaj, e cila ndryshon rregullat e lojës apo që cenon jetën publike në vend. Janë dy koncepte të ndryshme.

Dimitar Beça është miku im dhe do t’i them, sa të mbaroj, që u përmende në mbledhjen e Komisionit të Politikës së Jashtme, dhe ta garantoј se do të ndihet shumë i nderuar; është studiues bullgar. E kam librin, jua vë edhe në dispozicion, që flet për rolin e Rusisë në Europën Juglindore, sepse Rusia duhet ta dimë që edhe në strategjinë e saj të sigurisë kombëtare e ka të ndryshuar konceptin, nuk flet për Ballkan Perëndimor, sepse i duket sikur njësohet me Bashkimin Europian, flet për Europën Juglindore, një koncept shumë më i gjerë. Europa Juglindore është edhe Greqia, ku jo më larg se dje, qeveria greke deklaroi se Rusia është një partner i pazëvendësueshëm në këtë kënd të Europës. Prandaj po ju them: mos ta fusim veten në ujërat e turbullta që nuk e ka futur asnjë parlament. Nuk ka një rezolutë të parlamenteve demokratike në Shqipëri, pas ’90-ës, që të jetë marrë me emra shtetesh. Koha kur ne u shpallnim luftë shteteve të ndryshme ka përfunduar më 8 dhjetor 1990.

Së dyti, supozojmë se ne jemi përballë një rreziku dhe një kërcënimi. Unë kam një pyetje që, në fakt, është retorike, sepse pyetjeve konkrete që bëra, nuk u dha përgjigje njeri. Në rast se ne jemi përballë këtij kërcënimi që nuk e identifikojnë dot një mal me dokumente, që janë në bankën e të dhënave të sigurisë kombëtare të këtij vendi; në rast se nuk e kemi që çdo 2 vjet Ministria e Mbrojtjes të përditësojë një dokument, që është dokumenti i strategjisë së mbrojtjes, që bëhet në bashkëpunim me NATO-n, në mënyrë periodike rishikohet Strategjia e Sigurisë Kombëtare (e kam këtu) dhe habitem pse ...

Mimi Kodheli – Të lutem, zoti Bushati, më shterues!

Ditmir Bushati – Pse nuk shkojnë te Strategjia e Sigurisë Kombëtare? Është pika jonë orientuese, është dokumenti, i cili na orienton për mënyrën se si ne duhet të mbrojmë interesin tonë kombëtar. Është klasifikimi i rreziqeve, terminologjia Strategjia e Sigurisë Kombëtare nuk përmend emra shtetesh, kjo nuk ndodh në asnjë vend serioz në botë; ajo flet për aktorë shtetërorë dhe aktorë joshetërorë. Ky është koncepti që përdoret. Ky është koncepti që përdoret në të gjitha këto strategji që përmendim.

Një gjë tjetër, gjithashtu, rëndësishme: folët për linjëzimin dhe thatë zoti Balla se, duke e miratuar në këtë rezolutë siç është, shprehim vullnetin tonë për t'u linjëzuar me Bashkimin Europian. Zoti Balla, rezolutat e Parlamentit Europian nuk kanë asnjë lidhje me procesin e linjëzimit. Më vjen keq t'ju them, por si nxënësi i mirë, nuk më lë mania për ta thënë. Më vjen keq t'ju them! Janë vetëm vendimet e Bashkimit Europian, qëndrimet e Bashkimit Europian dhe në disa raste janë deklaratat e përfaqësuesit të lartë të politikës së jashtme të Bashkimit Europian. Bashkimi Europian ka një metodologji se si e mat performancën e këtyre vendeve.

Ashtu siç e tha me të drejtës zoti Gjoni, vende pararojë jemi ne dhe Mali i Zi në këtë pikë, sepse ka vende të tjera që kanë preferuar për t'u ulur në të dyja karriget, edhe në karrige me BE-në, edhe në karrige me vende të tjera. Përsëri po ju them se ky nuk është rasti, prandaj nuk është mirë që ne të themi: ky është rasti. Në qoftë se doni linjëzimin, jua marr unë. Linjëzimi është strategjia globale për politikën e jashtme të Bashkimit Europian, që është miratuar nga Bashkimi Europian, u është dhënë për konsultim vendeve kandidate. Shikojeni në këtë dokument, sepse është dokument publik. Ballkani Perëndimor përmendet 4 herë, meqenëse ju referuat këtu. Shikoni se për çfarë përmendet Ballkani Perëndimor. Qëllimi kryesor dhe sfida kryesore është rezistencë dhe fuqizimi i proceseve demokratike. Shikoni sa herë përmendet Rusia në atë dokument. Përmendet 9 herë. Shikoni se për çfarë përmendet Rusia në atë dokument. Shikoni sa herë përmendet Kina në atë dokument. Shikoni se si e adreson Bashkimi Europian. Pra, flasim për politikën e jashtme dhe flasim për çështjet që

ngërthejnë një interes strategjik. Prandaj po ju them: qeveria shqiptare dhe të gjitha instancat, të cilat janë në varësi të qeverisë shqiptare (jua them me garanci të plotë), kanë nivel të ndërgjegjësimit maksimal, sepse jemi vend anëtar i NATO-s. Ju i pari, nuk duhet ta kishit lejuar atë rezolutë që të vinte pa pasur një referencë për NATO-n. Çfarë do t'i përmirësojmë asaj kur ajo nuk ka konceptin strategjik të NATO-s? Është koncepti strategjik i NATO-s. Çfarë do të diskutojmë? Ka qindra deklarata.

Mimi Kodheli - Ju lutem, zoti Bushati, mbylleni fjalën!

Ditmir Bushati – Të lutem, sepse për mua është shumë e rëndësishme! Këtu u përmend Lulzim Basha. Për mendimin tim, Lulzim Basha nuk ekziston fare në lidhje me këtë çështje. Edhe 10 palë zgjedhje ta kemi Lulzim Bashën, jam i bindur se do ta mundim në ballafaqim elektorale. Më intereson që të mos futemi në këto banalitete. Po ju them, në qoftë se ne ia lejojmë vetes që të marrim *copy paste* në mënyrë të gabuar një dokument të Parlamentit Europian, i cili vjen si shumatore e 20 dokumenteve, që nuk kanë lidhje fare me Shqipërinë dhe që nuk i ka analizuar njeri; në qoftë se këtu na vihet dhe na thuhet se nuk e di cili është qëndrimi i qeverisë që do çojë te Komisioni i Sigurisë Kombëtare; nuk e di a është në përputhje me sigurinë e Strategjisë Kombëtare; nuk e di a është në përputhje me strategjinë e sigurisë kibernetike, çfarë do të analizojmë ne këtu?! Çfarë duhet t'i përmirësojmë, se jam i gatshëm që ne ta përmirësojmë?

Mimi Kodheli - Zoti Bushati, edhe unë ashtu them se ne jemi këtu për ta diskutuar dhe për ta përmirësuar.

Ditmir Bushati – Çfarë duhet t'i përmirësojmë? Cilin proces demokratik kombëtar? Ai që thotë Parlamenti Europian mbi bazën e parimit të subsidiaritetit apo gafat tona që do të na qeshin, Shyqyr që nuk është Vasilika, se do të thoshte, kur të shikojnë minutat e takimit, do të tallen brezat e tjerë. Do t'ia lejojmë ne vetes këtë gjë?! Këtë po ju them. Kjo nuk është politikë. Kush kujton se kjo është PS-ja, PD-ja dhe LSI-ja e të tjera, e kanë gabim; opozitë parlamentare, opozitë joparlamentare e ka gabim. E ka thënë vetë Edi Rama, nuk ka nevojë ta thotë asnjëri nga ne këtu. Nuk i qërojmë hesapet politikisht me Lulzim Bashën, duke përfshirë aktorë të tjerë. E ka thënë publikisht. Kështu që, pse do ta bëjmë ne këtë diskutim këtu? Por po ju them se në këtë proces, zonja kryetare, duhet që ne si komision për dhënie mendimi, të kishim rolin kryesor në këtë proces, dhe jo për të dhënë mendimin. Ne si deputetë, para se të përfshihemi në këtë proces, që ju thoni, duhet që të jeni të kthjellët dhe të dimë: terminologjia a është në përputhje me të gjithë këtë dokument që ka miratuar shteti shqiptar? Zoti Balla, po ju them se nuk është dhe përsëri më shqetëson. Objektivat e kësaj rezolute janë përputhje? Po ju them se nuk janë. Tani, në qoftë se ne e kemi hallin se si

penetrojnë këto në medie, ne kemi qenë këtu dhe kemi bërë propozime për modele mbi pronësinë për medien, që nuk i ka asnjë vend i Bashkimit Europian. Zoti Balla, jemi ne këtu që kemi çuar një tekst në OSBE dhe në BE për paketën antishpifje dhe, në qoftë se duam referencë që të përmbushim standardet e OSBE-së dhe BE-së dhe në qoftë se keni nevojë për këtë gjë, po.

Po supozojmë se e miratuam këtë dokument siç është, jam Edi Rama, Kryeministri i Shqipërisë, çfarë objektivash më keni vendosur si Kuvend? Çfarë mekanizmash dhe çfarë detyrash më keni dhënë që unë si kam bërë deri më sot? Jam kreu i Shërbimit Informativ: çfarë po më kërkoni që të bëj me këtë rezolutë, që nuk e kam bërë deri më sot? Jam kryetari i AKEP-it: çfarë po më kërkoni me këtë rezolutë që nuk e kam bërë deri më sot? A patëm një bashkëpunim deri para pak javësh dhe miratuam një rezolutë për procesin e integritetit, zoti Balla? I vendosëm vetes disa objektiva dhe disa afate, thamë brenda dhjetorit kjo, brenda vitit tjetër kjo. Ky institucion të bëjë këtë. Ky institucion tjetër të bëjë këtë gjënë tjetër. Duam të bëjmë një gjë të tillë. Jam 100% dakord me ju që duam. Po hajdeni të kemi një analizë paraprake dhe këtë analizën paraprake, nuk mund ta bëjmë mbi opinione personale, as se çfarë po bën sot për sot Parlamenti Europian, as dënimi për *Marie le Pen*... Këtë gjë mund ta bëjmë duke u nisur, së pari, nga interesi ynë kombëtar dhe interesin tonë kombëtar, duhet ta përcaktojmë perimetrin e interesit tonë kombëtar bazuar mbi analizën dhe informacionet që na sjell qeveria e Shqipërisë.

Në fund si deputet mund të kemi të drejtën dhe mund të themi nuk jemi dakord me këtë që ka sjellë qeveria apo jemi plotësisht dakord me këtë që ka sjellë qeveria, apo hajdeni ta përmirësojmë. Edhe ata në Parlamentin Europian e kanë bërë, pasi kanë ato 15 dokumentet, që jua lexoj, po të doni, por i keni aty edhe ato 15 dokumente apo 20 dokumente. Ishin punë ndër vite e Komisionit Europian dhe instancave të tjera të specializuara. Unë po ju them e kam parë axhendën dixhitale, kam ngritur dorën në qeveri kur e kemi miratuar strategjinë për sigurinë kombëtare. Kam ardhur në parlament dhe e kam prezantuar. Ne e kemi këtë si rrezik. Dakord. Zoti Gjoni e ka të saktë kur thotë se rreziku numër një për sigurinë kombëtare në Shqipëri është krimi dhe korrupsioni. E kemi pranuar vetë në 2014-n dhe kemi bërë shumë mirë që e kemi pranuar në këtë dokument, sepse e dimë që ekziston.

Rreziku kibernetik dhe ndërhyrjet e huaja është prioriteti i tretë apo i katërt në këtë dokument, ka terminologjinë, ka edhe mënyrën si e adreson.

Me këtë rezolutë duam t'u kërkojmë llogari këtyre institucioneve, që nuk e kanë bërë punën? Hajdeni, o burra, por të bëjmë një analizë, të bëjmë një proces! T'i thërrasim një nga

një, të bëjmë një kalendar pune, të thërrasim dy reporterë, në fund të bëjmë edhe një raport dhe hajdeni të ecim para! Po çfarë do t'i rregullojmë kësaj? Këtë po ju them. Ne kemi nevojë....

Mimi Kodheli – Zoti Bushati, të lutem!

Ditmir Bushati – Zonja Kodheli, as nuk po bëj propagandë... Më duroni, se e kam të nevojshme t'ju them, edhe në funksion të arritjeve që ka ky vend, sepse ky është vend anëtar i NATO-s, nuk është vend dordolec! Po ju them edhe një herë tjetër, ky është vend anëtar i NATO-s.

Mimi Kodheli – Patjetër.

Ditmir Bushati – Edhe juve dy vjet ju është dashur për të lëvizur nga Ministria e Mbrojtjes, ku ishit në bulevard, te Shkolla e Bashkuar, se është vend anëtar i NATO-s, sepse kishte një infrastrukturë digjitale aty, që e certifikon dikush tjetër dhe nuk mund të diskutojmë në një rezolutë për sigurinë kibernetike për dezinformacionin njërin-tjetrin pa pasur konceptin e NATO-s. Në qoftë se ju doni ta bëni, bëjeni!

Në qoftë se ju duket sikur po ju bezdis me këto që po ju them, bëjini të gjitha, në qoftë se është ky halli! Bëjini, por unë po ju them që neve na duhet një qasje kombëtare për këtë proces, siç e ka qeveria shqiptare, siç e kanë të gjitha qeveritë shqiptare me të metat e tyre, me defektet e tyre, me boshllëqet e tyre dhe ne nuk mund të dalim jashtë kësaj tradite!

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Zoti Shameti, për procedurë. Fjala është për ju.

Adnor Shameti - Faleminderit shumë!

Me gjithë respektin për kolegët e nderuar, do t'ju lutesha t'ia kursenim njëri-tjetrit dhe publikut leksionet në të drejtën ndërkombëtare.

Kemi një projektrezolutë të paraqitur këtu. Ju kujtoj se ka gati 15 ditë që është paraqitur dhe i është komunikuar të gjithë deputetëve të parlamentit shqiptar. Kështu që gjithsecili prej nesh në këtë komision të nderuar dhe në gjithë parlamentin shqiptar ka pasur kohën e nevojshme, që ato sugjerime për të cilat fola, por nuk i dëgjoi njeri, pak më parë...

Mimi Kodheli – Jo, i dëgjuam me vëmendje. Personalisht, po.

Adnor Shameti – Secili prej nesh i kishte të gjitha mundësitë të vinte me një propozim konkret dhe këtu në Komisionin e Politikës së Jashtme të zbatojmë procedurat e votimit, nga propozimi më i largët ta hedhim në votim. E pranojmë apo nuk e pranojmë, secili prej nesh është i mirëpritur për çdo ndërhyrje.

Me gjithë ndërhyrjet e kolegëve të nderuar, vetëm propozime konkrete nuk dëgjova në asnjë fjali apo paragraf të kësaj rezolute.

Në këto kushte, do t'ju lutesha shumë ta përmbyllim këtë, të jemi operativë, se kemi edhe gjera të tjera, dhe të kalojmë në votim!

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Jo, nuk do t'jua jap fjalën.

Kolegë të nderuar...

Jo, zoti Bushati, nuk do t'jua jap fjalën.

...ndaj të njëjtin mendim me propozimin e fundit të zotit Shameti. Personalisht, si anëtare e këtij komisioni, kam disa propozime që nuk kanë të bëjnë me thelbin, por me formën, me mënyrën se si janë parashtruar dhe shkruar disa paragrafë.

Kështu që, meqenëse ne nuk jemi komision përgjegjës, por jemi komision për dhënie mendimi (në fakt, ndaj të njëjtin opinion me ish-ministrin Bushati, mund të ishim komision përgjegjës, por sot që flasim është fakt që jemi komision për dhënie mendimi), mendoj se kemi mjaftueshëm kohë për të parashtruar të gjitha propozimet tona, të cilat do t'i shkojnë si mendim Komisionit të Sigurisë.

Nga ana tjetër, zoti Balla, mendoj se është e nevojshme, në detyrimin tonë jo vetëm moral, por edhe ligjor, që të gjithë anëtarët e Komisionit për Politikën e Jashtme, që disponojnë certifikata sigurie të një niveli të caktuar dhe mund të informohen për dokumente të klasifikuara, të mund të jenë pjesë e diskutimit në Komisionin e Sigurisë dhe përveç propozimeve konkrete që mund t'i vijnë rezolutës, të mund të kërkojmë edhe dokumente plotësuese qoftë nga qeveria, qoftë nga agjencitë e informacioneve apo të sigurisë, për çështjen për të cilën folëm.

Kështu që, pa dashur të vë rregulla të reja loje mbi atë që e kemi të shenjtë në këtë komision, harmoninë midis njëri-tjetrit, mendoj ta hedhim rezolutën në votim në parim.

Ndërkohë, ju siguroj se asgjë nuk do të kalojë, qoftë mbledhja e Komisionit të Sigurisë, qoftë rezoluta, pa reflektuar në shumicë të gjitha propozimet e drejta, që erdhën nga...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ralf Gjoni – Pse doni t'i kaloni shpejt e shpejt gjërat?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja kryetare, për procedurë, ju lutem! Nuk është normale kjo. Ju lutem!

Mimi Kodheli – E hedh në votim.

Ralf Gjoni – Ka probleme strukture kjo rezolutë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është normale.

Mimi Kodheli – Kush është dakord në parim me rezolutën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ju lutem, zoti Balla!

Kolegë, ju ftoj...

Zoti Gjoni, ju lutem, se ju kam dëgjuar tri herë...

Ralf Gjoni – Ka probleme strukture.

Mimi Kodheli – Problemet strukture do t'i komentoni dhe do të bëni propozimet tuaja pranë Komisionit të Sigurisë.

Komisionin e deklaroj të mbyllur.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA